



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 8, datë 05. 04. 2012

PËR

**"KRIJIMIN E GALERISË SË ARTIT BASHKËKOHOR, "TIRANA ART GALLERY"
DHE MIRATIMI I STRUKTURËS ORGANIZATIVE"**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 8, pikave 1 dhe 3/II, gërma "a" të nenit 10 dhe pikës "ç" të nenit 32 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore" (i ndryshuar); ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar); nenit 5, shkronja "a" të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për "Kompetencat për caktimin e pagave të punës" (i ndryshuar); neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 për "Artin dhe Kulturën"; ligjit nr. 7582, datë 13.07.1992 për "Ndërmarrjet shtetërore", (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 03.04.1993 për "Kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore", (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1619, datë 02.07.2008 për "Klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësisve të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore" (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.566, datë 14.07.2010 për "Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.25, datë 28.12.2011 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2012", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë krijimin e galerisë së artit bashkëkohor, Tiranë " Tirana Art Gallery ", e cila do të ushtrojë veprimtarinë në objektin e ndodhur në rrugën "Murat Toptani", të përcaktuar në pikën 8 të këtij vendimi.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi, të miratohet struktura organizative sipas organigramës bashkëlidhur, si dhe niveli i pagave për punonjësit, sipas lidhjes nr.14, bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Veprimet financiare për funksionimin e Galerisë së Artit Bashkëkohor do të kryhen nga Drejtoria e Financës, aparati i Bashkisë së Tiranës.
4. Efektet financiare të zbatimit të këtij vendimi do të fillojnë 15 ditë pas marrjes në dorëzim të objektit .
5. Efektet financiare për shpenzime personeli dhe operative do të përballohen duke pakësuar fondet e miratuara për paga të Aparatit të Bashkisë në Gr.00.Tit.01110.Art.600, në

shumën 3 492 000 lekë dhe do të shpërndahen për galerinë e “ Tirana Art Gallery ”, pranë Bashkisë së Tiranës, në Gr.00.Tit.08250, në artikujt si më poshtë:


a) Zëri 600 “Paga”	2 180 000 lekë
b) Zëri 601 “Sigurime Shoqërore”	320 000 lekë
c) Zëri 602 “Shpenzime Operative”	400 000 lekë
d) Zëri 231 “Blerje pajisje zyre e kompjuterike”	592 000 lekë

6. Fondi prej 2 400 000 lekë për projekte kulturore të “ Tirana Art Gallery ”, do të përballohet duke pakësuar në të njëjtën shumë zërin “Projekte kulturore” (art.602), i planifikuar për Aparatin e Bashkisë.
7. Fondi prej 12 952 982 lekë për rikonstrukcionin e ambjenteve të galerisë, do të përballohet nga donatorë dhe partneriteti me biznese.
8. Kalimin kapital të objektit të Ndërmarrjes së Dekorit në rrugën “Murat Toptani” nga Ndërmarrja e Dekorit, në Aparatin e Bashkisë së Tiranës, me qëllim ngritjen e galerisë “ Tirana Art Gallery ”.
 - Objekti në rrugën “Murat Toptani”
 - Sipërfaqja totale 266 m katror.
 - Vlera kontabël 60 300 lekë.
9. Në zbatim të pikës 8 të këtij vendimi, të kryhet ndryshimi i destinacionit të këtij objekti në objekt kulturor, si dhe të kryhen veprimet përkatëse për reflektimin e vlerave kontabël sipas ligjit “Për kontabilitetin”, pranë Ndërmarrjes së Dekorit dhe aparatit të Bashkisë Tiranë.
10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Artit dhe Kulturës, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Financës dhe galeria e artit bashkëkohor, “ Tirana Art Gallery ”, për zbatimin e këtij vendimi.
11. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI

ORGANIGRAMA E GALERISË SË ARTIT BASHKËKOHOR, TIRANË "T.A.G. CONTEMPORARY"



Lidhja nr.14

NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJESIT E GALERISË SË ARTIT BASHKËKOHOR, TIRANË "T.A.G. contemporary"

		PAGA MUJORE		
Klasa	Kategoritë	Paga individuale		Shtesa e pozicionit
	1	2	3	4
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion
II	II-b	1	2%	88.000
III	III-a	1	2%	69.000
	III-b	1 ose 2	2%	52.000
Specialist i mesëm				30 000

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND); Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND); Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	13000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP); Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10000 lekë

Shtesa për vjetërsi në punë **të jepet në masën 2%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet mbi **pagën e grupit**.